



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.37.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE
TË KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmerrë edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës së Mitrovicës Veriore në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Sejdiu, i mbështetur nga, Svetlana Perović (Udhëheqëse Ekipi), dhe anëtarëve Stana Dančetović dhe Agim Sogojeva.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	8
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	13
4 Qeverisja.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	26
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	29


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të komunës së Mitrovicës Veriore për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet ndërkombëtarisht të njohura të auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 07/10/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opiniononi

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opiniononi i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksimi të Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Pasuritë Fikse dhe shpalosja e tyre në PVF nuk është e plotë.


Çështje tjera

Investimet kapitale në PVF për 9,800€ pasi që komuna nga kjo kategori kishte paguar shërbime dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin mbideklaruar për 58,503€ për shkak të keqklasifikimit.


(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e komunës janë:







Përgjigjja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i komunës është pajtuar me të gjitha gjetjet tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

Ne e marrim si punë të kryer faktin që Kryetari :

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit janar/shkurt 2016 të inicioj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të komunës së Mitrovicës Veriore të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë e auditimit fokusohet në vlerësimin dhe të kuptuarit e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të rezultateve cilësore operationale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operationale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit, ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Në përgjithësi cilësia e PVF-ve ishte e mirë, me përjashtim të shpalosjeve mbi pasuritë e komunës. Siç është thënë në brendi të këtij raporti, obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF-të, ishin përmbushur, përveç raportit të vetëvlerësimit.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksimi të Çështjes* dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Pasuritë Fikse dhe shpalosja e tyre në PVF nuk është e plotë.

Çështje tjera

Investimet kapitale në PVF për 9,800€ pasi që komuna nga kjo kategori kishte paguar shërbime dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin mbideklaruar për 58,503€ për shkak të keqklasifikimit.

(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, e datës 7/10/2014, është identifikuar një rrezik domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me plotësinë e pasurive ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rrezikun e identifikuar. Mungesa e veprimeve për adresimin e rrezikut domethënës mund të rezultojë me Theksim të Çëshjtes.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF

Përgjigjja dhe gjetjet e auditimit

Gjatë auditimit të ndërmjetëm ne kemi shqyrtuar kontrollet e menaxhmentit dhe proceset shoqëruese për të siguruar një regjistër të plotë të pasurive. Ne i kemi ofruar këshilla menaxhmentit për veprimet të cilat duhet të ndërmerren që vlera e pasurisë në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar për shkak se menaxhmenti nuk ka arritur t'i zbatojë kontrollet e duhura në menaxhimin e pasurive që do të siguronin pasqyrimin e tyre të plotë në PVF.

Rekomandimi 1 Prioritet i Lartë - Kryetari i komunës duhet të inicioj analizë të shkaqeve që kanë çuar në vlera të pasakta të pasurive në PVF. Kryetari duhet të identifikojë veprime adekuate për adresimin e këtyre dobësive për të siguruar shpallje të plotë të pasurive në PVF-të e vitit 2015. Ky proces duhet të monitorohet në mënyrë sistematike nga ana e Kryetarit. .

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese si dhe duhet të përmbushen kërkesat tjera për raportim të jashtëm. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Nëse PVF janë përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe dhe janë dorëzuar në kohë;
- Nëse PVF janë nënshkruar nga Kryetari i komunës dhe nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF);

- Raportimin e rregullt tremujor te Kuvendi Komunal dhe Ministria e Financave;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Nëse draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është përgatitur me kohë.

Në kontekst të PVF-ve, ne kemi identifikuar disa mos pajtueshmëri ngase në shënimin 31 dhe 32, shpalosjet mbi pasuritë e komunës nuk ishin të plota. Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne kemi identifikuar se komuna nuk kishe përgatitur raportin e vetëvlerësimit siç kërkohet me procedurat e MFK-së.

Rekomandimi 2 Prioritet i Lartë - Kryetari i komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF-ve të vitit 2015 adreson të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse në të gjitha draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme. Kryetari i komunës, gjithashtu, duhet të sigurojë se të gjitha kërkesat për raportim të jashtëm do të përmbushen.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Edhe pse komuna ka përgatitur një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve tona të vitit 2013, një pjesë e rekomandimeve ende nuk është adresuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 ka rezultuar në 18 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2014, plotësisht janë adresuar shtatë (7) rekomandime; tri (3) janë adresuar pjesërisht, derisa (tetë) 8 prej tyre nuk janë trajtuar.

Për përshkrim të detajuar të rekomandimeve dhe si janë adresuar ato, ju lutem shihni Shtojcën II.

Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Rreth 1/3 e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar, sepse menaxhmenti nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP.
- Rreziku** Mos adresimi i rekomandimeve rezulton me dobësi të vazhdueshme të kontrolleve në sistemet kyçe financiare. Rekomandimet nuk janë adresuar në fushat kryesore, si: të hyrat, shpenzimet, pagat, subvencionet dhe pasuritë, dhe si rezultat i kësaj, dobësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten. Kjo rrit rrezikun e realizmit të objektivave dhe mund të rezultojë me vlerë të dobët për paranë.
- Rekomandimi 3** Kryetari i komunës duhet të sigurojë se një plan veprimi i rishikuar, për adresim të rekomandimeve të mbetura nga viti 2013, së bashku me rekomandimet e 2014, e përcakton një orar të qartë të zbatimit të tyre. Ky plan duhet t'i identifikoj afatet kohore, stafin përgjegjës dhe të përqendrohet fillimisht në fushat e rëndësishme më të madhe. Progresi i zbatimit të këtij plani duhet të mbikëqyret direkt nga ana e Kryetarit.

4 Qeverisja

Përshkrimi

Një qeverisje e mirëfilltë mbështet planifikimin efektiv, implementimin dhe monitorimin e aktiviteteve të komunës. Aspektet kyçe që duhet adresuar komuna e Mitrovicës Veriore për të mundësuar një kornizë të mirë qeverisëse janë: Procedurat e qarta dhe ndarje adekuate e detyrave për menaxhimin e proceseve, menaxhimi i rrezikut, monitorimi sistematik i aktiviteteve dhe vetëvlerësimi.

Mitrovica e Veriut ende nuk ka arritur t'i vendosë aranzhimet e nevojshme për të siguruar përmbushjen e këtyre aspekteve qeverisëse. Përkundër zotimit të komunës për të vendosur një sistem të duhur të menaxhimit dhe kontrollit, një gjë e tillë nuk është arritur, dhe ka mjaft hapësirë për përmirësim. Aspekti kryesor për sigurimin e zhvillimit të kërkuar është një proces i mirë i tranzicionit duke siguruar që kultura dhe praktikrat nga Zyra e mëhershme Administrative (ZA) dhe Komunës janë përmbushur, me qëllim të krijimit të një baze të qëndrueshme për ofrimin efektiv të shërbimeve ndaj qytetarëve.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Menaxhimi dhe kontrolli i financave publike realizohet përmes sistemit të integruar të aktiviteteve të përditshme operative dhe financiare. Për të siguruar menaxhim efektiv financiar, nevojitet një proces efektiv dhe me kohë i raportimit.

Rekomandimet

Çështja 4 – Dobësi në proceset e raportimit – Prioritet i Lartë

E gjetura	Rishikimi i ynë ka identifikuar një kontroll të dobët nga menaxhmenti mbi shpenzimet dhe të hyrat e komunës. Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk ka arritur të vendosë procese të raportimeve menaxheriale që ofrojnë shpjegime rreth dallimeve ndërmjet buxhetit dhe realizimit. Për më tepër, përgjegjësitë e mëparshme të zyrës administrative dhe komunës aktuale ende nuk janë harmonizuar. Prandaj, aktivitetet e komunës nuk janë zhvilluar si duhet.
Rreziku	Cilësia e dobët e llogaridhënies dhe raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë redukton efektivitetin e aktiviteteve dhe kontrollit buxhetor të komunës. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe mungesë të veprimeve të nevojshme për adresimin e tyre.

Rekomandimi 4 Kryetari i komunës duhet të inicioj një rishikim të praktikave aktuale të raportimit për të përcaktuar cilësinë e raportimin financiar dhe formimin e një baze të mjaftueshme të monitorimit tek menaxhmenti i lartë, për të siguruar një menaxhim efektiv të veprimtarisë. Një zgjidhje të përshtatshme duhet të prezantohet deri në fund të 2015-tës.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Alokimet buxhetore për komunën e Mitrovicës Veriore janë të përfshira në linjën buxhetore të ish-Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore. Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	4,078,656	4,779,314	4,427,037	3,745,762	1,258,657
Granti i Qeverisë -Buxheti	3,973,256	4,657,279	4,402,433	3,573,187	1,258,657
Të bartura nga viti paraprak ² –	0	11,944	12,660	20,500	0
Të hyrat vetjake ³	105,400	105,400	11,944	0	0
Donacionet e jashtme		4,691	0	152,075	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 700,658€. Kjo rritje është rezultat i:

- rritjes së grantit të qeverisë në shumë 684,024€;
- bartjes së të hyrave vetjake nga viti 2013 në shumë 11,944€; dhe
- donacionit të Qeverisë Norvegjeze në shumë 4,691€.

Ekzekutimi i buxhetit final në vitin 2014 është 93%, dhe që paraqet një shkallë përmirësimi prej 16% krahasuar me vitin 2013. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	4,078,656	4,779,314	4,427,037	3,745,762	1,258,657
Pagat dhe Mëditjet	2,520,000	3,208,664	3,173,582	2,376,703	857,591
Mallrat dhe Shërbimet	475,990	476,040	369,630	628,519	130,751
Shërbimet komunale	39,072	39,072	20,642	39,071	642
Subvencionet dhe Transferet	110,000	121,944	67,166	49,584	0
Investimet Kapitale	933,594	933,594	796,017	651,885	269,673

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje gjatë vitit 2014 ishte rritur për 688,664€. Kjo ka ndodhur për shkak të vendimit të qeverisë për ngritjen e pagave për 25% si dhe për shkak të transferimit të personelit të punësuar në shëndetësi dhe arsim në sistemin e pagave të Kosovës. Si rezultat është arritur niveli i shpenzimit për këtë kategori në 99% të buxhetit final, e që është 17% më i lartë krahasuar me vitin paraprak;
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime për vitin 2014 ishin në nivel 78% të buxhetit final. Ky nivel shënon rënie të shpenzimit të buxhetit final për 19% krahasuar me vitin paraprak;
- Buxheti për shërbimet komunale është shpenzuar në nivel 52%;
- Edhe përkundër faktit që buxheti për subvencione dhe transfere ishte rritur për 11,911€, niveli i shpenzimit të buxhetit final ishte vetëm 55% apo 14% më i ulët se vitin paraprak. Ky nivel i ulët i shpenzimeve është rezultat i mungesës së një strategjie të komunës për përkrahjen e projekteve përmes subvencione; dhe
- Buxheti final për investime kapitale ishte shpenzuar në shkallë prej 85% duke treguar një përmirësim për 31% krahasuar me vitin paraprak. Sidoqoftë, fakti që 78% e shpenzimeve janë realizuar në tremujorin e fundit është indikatorë i një planifikimi të dobët për menaxhimin e projekteve kapitale.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat	105,400	105,400	20,532	10,612	107

Vetëm 19% e planit për inkasimin e të hyrave vetjake gjatë vitit 2014 ishte realizuar. Niveli i inkasimit të të hyrave vetjake mbetet në nivel tejet të ulët. Ky nivel i realizimit është i tillë për shkak që komuna ka planifikuar të hyra nga lejet e ndërtimit ndërsa nuk ka realizuar asnjë të hyrë. Kjo tregon një mungesë të mekanizmave efektiv për inkasimin e të hyrave të planifikuara.

Ndonëse plani i të hyrave vetëm pjesërisht është realizuar, megjithatë është pozitiv fakti se të hyrat janë dyfishuar në krahasim me vitin e kaluar.

Rekomandimet

Çështja 5 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë

E gjetura Edhe pse realizimi i përgjithshëm i buxhetit ishte në nivel të pranuar, komponentet e buxhetit të shpenzimet komunale dhe subvencionet janë shpenzuar në nivel të ulët të krahasuar me planin. Pjesa më e madhe e shpenzimeve ka ndodhur në tre-mujorin e fundit, ndërsa shuma e donacioneve ka mbetur krejtësisht e pashpenzuar pasi që ishte pranuar në fund të vitit 2014. Këto tregojnë për dobësi të komunës në planifikimin e buxhetit dhe në kontrollin sistematik buxhetor si rezultat i periudhës së tranzicionit.

Rreziku Planifikimi dhe realizimi jo i duhur i buxhetit rezulton me performancë të dobët dhe zvogëlon efektivitetin e komunës në arritjen e objektivave. Në anën tjetër mos-përmbushja e programit buxhetor mund të rezultojë në reduktim të grantit qeveritar dhe humbje të donacioneve me pasoja në ngecje të zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës.

Rekomandimi 5 Kryetari i komunës duhet të iniciojë në analizë të shkaqeve të dobësisit të performancës buxhetore në kategoritë e caktuara ekonomike. Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor reflekton nevojat dhe kapacitetet e komunës dhe në mënyrë sistematike duhet të monitorojë realizimin kundrejt planifikimit.

Çështja 6 - Mbivlerësimi i mallrave dhe shërbimeve – Prioritet i Lartë

E gjetura Nga buxheti për mallra dhe shërbime, komuna ka paguar 58,503€ për paga dhe mëditje të këshilltarëve komunal. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka arritur të planifikojë shumat e nevojshme në kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

- Rreziku** Mbivlerësimi i mallrave dhe shërbimeve mund të shpie në keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe mund të jetë bazë për Modifikim të Opinionit.
- Rekomandimi 6** Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që të gjitha shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe se ato nuk do të jenë subjekt i keq klasifikimit.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Të hyrat e gjithmbarshme të komunës së Mitrovicës Veriore për vitin 2014 ishin 20,532€. Këto të hyra burojnë nga taksat administrative, taksat nga regjistrimi i trashëgimisë, nga lëshimi i certifikatave të lindjes dhe vdekjes dhe gjobave të tjera.

Komuna ka bërë progres në vendosjen e kontroleve për menaxhimin e të hyrave vetjake, por këto kontrole duhet vendosmërisht të aplikohen, forcohen dhe monitorohen në mënyrë sistematike për të dhënë rezultatin e pritur.

Rekomandimet

Çështja 7 - Dobësi në menaxhimin e të hyrave - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Menaxhmenti i komunës nuk zbaton politika efikase lidhur me të hyrat. Duket se problemi është i natyrës politike dhe qytetarët refuzojnë të paguajnë taksat shtetërore. Dobësitë e identifikuara janë:
- Mungesë e proceseve adekuate për një planifikim real dhe të zbatueshëm mbi të hyrat e komunës. Kjo ka shkaktuar që vetëm 19% e planifikimit të realizohet; dhe
 - Mungesa e mekanizmave efektiv të siguruar inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe nga lejet e ndërtimit.
- Rreziku** Dobësitë ekzistuese do të rezultojnë me shkallë të ulët të inkasimit të të hyrave vetjake. Si rezultat, komuna do të përballet me mos realizim të planit dhe me mundësi të reduktuara për realizimin e projekteve që pritet të financohen nga të hyrat vetjake.
- Rekomandimi 7** Kryetari i komunës duhet të jetë më i vendosur me inkasimin e taksave, , sepse të hyrat vetjake u kthehen përsëri këtyre qytetarëve në formë të projekteve apo shërbimeve.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Blerjet e realizuara përmes procedurave të prokurimit në vitin 2014 ishin 913,686€. Këtu hyjnë investimet kapitale dhe pjesa dërmuese e mallrave dhe shërbimeve. Përsëritja e dobësive nga vitet e kaluara tregon që prokurimi vazhdon të jetë sfidë për komunën.

Rekomandimet

Çështja 8 – Dobësi në prokurim – Prioritet i Mesëm

E gjetura	<p>Nga shqyrtimi i kontratave të prokurimit, ne kemi identifikuar që komuna nuk kishte zbatuar plotësisht LPP-në. Si pasojë janë paraqitur dobësitë në vazhdim:</p> <ul style="list-style-type: none">• Pagesa në shumë 9,800€ për shërbime për „Pastrim dhe mirëmbajtje të hapësirave të gjelbëruara publike“ ishte bërë nga kategoria e investimeve kapitale;• Dy kontrata për punë, në vlerë 69,820€, ishin lidhur edhe pse Operatorët Ekonomik (OE) nuk kishin ofruar dëshmi të vlefshme mbi numrin e punëtorëve të angazhuar.
Rreziku	<p>Dobësitë e theksuara tregojnë mungesë të efektivitetit të kontrolleve të prokurimit. Kjo mund të rezultojë me shkelje të legjislacionit dhe dështim të operatorëve në përfundimin e punëve.</p>
Rekomandimi 8	<p>Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet e prokurimit, dhe të vendos kontrolle shtesë për të siguruar rregullsinë dhe efektivitetin e procesit. Të gjitha pagesat duhet të bëhen në kode adekuate dhe kontratat duhet të lidhen vetëm me OE që i plotësojnë të gjitha kriteret e tenderit në përputhje të plotë me LPP.</p>

Çështja 9 – Dobësi në përdorimin e ‘kuotimit të çmimeve’ – Prioritet i Lartë

E gjetura Ne kemi identifikuar që nga 83 procedura të prokurimit të implementuara gjatë vitit 2014, përmes procedurës ‘kuotim i çmimeve’ ishin 43 raste. Vlera totale e kontratave të nënshkruara përmes kuotimit ishte 348,689€. Në vazhdim janë paraqitur rastet që mund të jenë subjekt i ndarjes së qëllimshme të kontratave:

- Me 12.12.2014 komuna kishte lidhur dy kontrata, përmes ‘kuotimit të çmimeve’ për natyrë të ngjashme të furnizimit. Njëra ishte për “Blerje të uniformave për zjarrfikësit” në vlerë prej 8,910€ dhe tjetra për “Blerjen e pajisjeve për fikjen e zjarrit” në vlerë prej 3,200€; dhe
- Më 19.12.2014 janë nënshkruar 6 kontrata në vlerë totale 49,560€ për furnizime të natyrës së njëjtë, siç janë inventar, pajisje dhe material mjekësor. Në të gjitha kontratat ishte zbatuar procedura e ‘kuotimit të çmimeve’ duke anashkaluar procedurat e hapura. Për më tepër, informatat në fatura dhe pranim të mallrave, nuk ishin të njëjta me dosjen e tenderit.

Rreziku Përdorimi i procedurës së kuotimit për shpenzime që mund të realizohen me procedurë të hapur, shton rrezikun e përfitimit të ulët të vlerës për para, eliminon konkurrencën dhe mund të jetë subjekt i mashtrimit. Në anën tjetër, dallimi ndërmjet pranimit të mallrave dhe faturave me dosjen e tenderit mund të rezultojë me pagesa të parregullta.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në planifikimin dhe të vlerësoj me kohë nevojat për blerje/furnizime gjatë vitit për të siguruar që për artikujt e natyrës së njëjtë do të përdoren procedurat e hapura, në mënyrë që nga konkurrenca e tregut të nxirren çmimet sa më të arsyeshme. Po ashtu, me rastin e pranimit të mallrave/shërbimeve, të konfirmohet sasia, çmimet dhe cilësia në pajtim me kontratat, dhe pastaj duhet të çertifikohen pagesat.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Shpenzimet jo përmes prokurimit kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime për të cilat nuk kërkohet prokurim. Shembuj të këtyre shpenzimeve janë komunalitë, avancet për udhëtime, drekat zyrtare, shpenzimet përmes parasë së imët, etj. Janë disa aspekte të procesit të shpenzimeve jo përmes prokurimit për të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, e që janë trajtuar nën kapitullin 4.5.2.

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2014 ishin 3,173,582€ apo 99% e buxhetit për këtë kategori. Çështjen e pagesës së pagave për këshilltarët komunal nga buxheti për mallra dhe shërbime e kemi trajtuar në kapitullin 4.2.

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Rekomandimet

Çështja 10 - Dobësi në menaxhimin e personelit - Prioritet i Lartë

E gjetura Rishikimi ynë ka identifikuar disa dobësi lidhur me menaxhimin e personelit. Kjo ka ndodhur pasi që komuna nuk ka zbatuar plotësisht rregulloret e caktuara për këtë fushë. Dobësitë e identifikuar janë:

- Tetë (8) të punësuarve në arsim u kishin skaduar kontratat e punës dhe të njëjtit ende vazhdojnë të paguhen. Për më tepër, ne nuk kemi qenë në gjendje të marrim dëshmi nëse personeli arsimor në të vërtetë e vijon punën për të cilën marrin paga;
- Komuna gjatë vitit 2014 kishte paguar për punë jashtë orarit 4,359€. Këto shpenzime janë bërë nga buxheti për paga ndërsa janë regjistruar gabimisht në kodin për paga të rregullta me orar të plotë;
- Komuna ende nuk ka zbatuar këshillën tonë për harmonizimin e pagave me kontratën. Si pasojë, 114 mësimdhënës në arsimin fillor marrin pagë bruto 77€ më të vogël se paga e përcaktuar në kontratë. Po ashtu, 151 profesorë marrin pagë bruto 60€ më të vogël se paga e përcaktuar në kontratë.

Rreziku Dobësitë e identifikuar në menaxhimin e personelit rezultojnë në pagesa të parregullta për paga. Mungesa e dëshmive për vijim të punës nga personeli, është indikacion se kanë ndodhur pagesa pa asnjë bazë ligjore. Për më tepër, këto mund të jenë subjekt i mashtrimit dhe bazë për Modifikim të Opinionit.

Rekomandimi 10 Kryetari i komunës duhet të iniciojë një analizë të arsyeve pse pagesat e pa rregullta kanë ndodhur dhe përmes Departamentit të Burimeve Njerëzore të sigurojë se të gjitha shpenzimet për paga e punëtorëve, të bëhen sipas bazës ligjore. Për të gjithë stafin të cilët nuk vijojnë aktivisht procesin e punës, pagesat e pagave duhet të ndërpriten menjëherë. Po ashtu, regjistrimet në kontabilitet duhet të bëhen në kodet adekuate.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Shpenzimet për subvencione dhe transfere në vitin 2014 ishin 67,166€ ose 55% e buxhetit final. Komuna kryesisht ka ndarë subvencione për përfitues jo-publik, përfitues individual, organizata jo-qeveritare dhe biznese.

Rekomandimet

Çështja 11 - Mungesa e rregullores - Prioritet i Mesëm

E gjetura Komuna ende nuk e ka zbatuar këshillën tonë për të miratuar rregulloren e cila do të përcaktonte kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve.

Rreziku Mungesa e rregullores së brendshme për subvencione paraqet rrezik që subvencionet të ndahen pa kriteret dhe të jenë subjekt i manipulimit dhe pagesave të parregullta. Kjo mund të rezultojë me rrjedhën e fondeve jashtë destinimeve të përcaktuara dhe mos arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi 11 Kryetari i komunës duhet të sigurojë që deri në fund të vitit 2015 të hartojë dhe aprovon në Kuvendin Komunal një rregullore e cila qartë përcakton kriteret dhe procedurat e ndarjeve të subvencioneve. Po ashtu, duhet të vendosen kontrole efektive që sigurojnë respektim të plotë të rregullores së aprovuar.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Vlera e përgjithshme e pasurive të shpalosura në PVF-të e vitit 2014 është 1,268,401€. Ne kemi identifikuar një rrezik domethënës lidhur me plotësinë e regjistrimit të pasurive. Kjo çështje është trajtuar në kapitullin 2.2.

Rekomandimet

Çështja 12 - Inventarizimi i pasurive - Prioritet i Mesëm

- E gjetura** Komuna kishte formuar komisionin për inventarizim të pasurive për vitin 2014 i cili ka përgatitur raportin e inventarizimit. Në këtë raport ishin identifikuar disa pasuri, prejardhja dhe vlera e të cilave nuk ishte dhënë. Me kërkesë të ZKF-së, këto pasuri ishin larguar nga hapësirat e komunës. Ne nuk kemi pranuar dëshmi për gjendjen, vendndodhjen apo vlerën e tyre pas largimit. Me këtë rast, komuna nuk ka zbatuar Rregullën Financiare 02/2013 për menaxhimin e pasurive qeveritare.
- Rreziku** Mungesa e dëshmive për procesin e hedhjes jashtë përdorimit të pasurive, mund të rezultojë me keqpërdorim dhe humbje të pasurive të komunës.
- Rekomandimi 12** Kryetari i komunës duhet të sigurojë një raport të detajuar lidhur me gjendjen dhe ndodhjen e pasurive të larguara nga hapësirat e komunës. Raporti duhet të analizojë arsyet e largimit të pasurive pa vendime formale të cilat përshkruajnë gjendjen funksionale e pasurive, prejardhjen, sasinë, vlerën e tyre dhe arsyet për hedhje jashtë përdorimit apo tjetërsim të tyre.

4.5.2 Trajtimi i parasë së gatshme

Përshkrimi

Paraja e gatshme (petty-cash) përdoret për shpenzime të vogla ditore të cilat nuk kanë mundur të planifikohen dhe që nuk kalojnë vlerën 100€.

Rekomandimet

Çështja 13 - Shfrytëzimi jo adekuat i Petty Cash-it - Prioritet i Mesëm

E gjetura Gjatë vitit 2014 komuna kishte shfrytëzuar paranë e gatshme për dreka zyrtare. Shuma e paguar nga paraja e gatshme për dreka zyrtare ishte 969€. Kjo ka ndodhur për shkak që komuna nuk ka zbatuar kërkesat e Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike.

Rreziku Përdorimi i parasë së gatshme për shpenzime më të larta se shuma e lejuar paraqet shkelje të rregullës financiare dhe mund të rezultojë me pagesa të parregullta.

Rekomandimi 13 Kryetari i komunës duhet të forcojë kontollet gjatë shpenzimit të parasë së gatshme. Paraja e gatshme duhet të përdoret ekskluzivisht për rastet e parapara me rregullën financiare. Të gjitha shpenzimet mbi 100€ duhet të kalojnë përmes procedurave të prokurimit.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Komuna e ka themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB). Kjo njësi e ka përgatitur planin vjetor strategjik të auditimit. NjAB për vitin 2014 i ka planifikuar katër auditime, por e ka kryer vetëm një auditim për menaxhimin e të hyrave.

Rekomandimet

Çështja 14 - NjAB jo funksionale - Prioritet i Lartë

E gjetura Kontrolli ynë për funksionimin e NjAB ka identifikuar se komuna nuk e ka kuptuar rolin e auditimit të brendshëm. Kjo i ka shkaktuar dobësitë në vijim.

- NjAB është jo funksionale qysh nga Qershori i vitit 2014 për shkak se auditori i brendshëm ka kaluar në pozitë tjetër brenda komunës; dhe
- Komiteti i auditimit nuk është formuar.

Rreziku Ndërprerja e funksionimit të NjAB dhe mos formimi i Komitetit të Auditimit mund të rezultojnë me përsëritjen e dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Në mungesë të auditimit të brendshëm, menaxhmentit i reduktohet mundësia që të ketë një vlerësim se në çfarë shkalle operojnë kontrollet e brendshme dhe nëse ato janë efektive.

Rekomandimi 14 Kryetari i komunës duhet të sigurojë që Njësia e Auditimit të Brendshëm është bërë funksional. Komiteti i Auditimit duhet të themelohet në mënyrë që të lehtësohet puna e auditimit të brendshëm dhe të kontribuojë në përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Këto janë nevoja vitale për komunën për të pasur siguri mbi efektivitetin e mjedisit të kontrollit të brendshëm.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht

ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e

auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2. Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	Prioriteti i lartë - Kryetari/ZKA duhet të identifikojë veprimin e duhur për ti adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014.			Nuk është adresuar.
2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF	Kryetari/ZKA duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF-ve të vitit 2014 të adresojë fushat që konsiderohen me rrezik të lartë të gabimit ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme. Duhet të sigurohen trajnime adekuate për stafin që ata të jenë të aftë për të regjistruar dhe përgatitur PVF me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullat financiare		Pjesërisht PVF ende nuk janë në rregull në lidhje me prezantimin e pasurive	
2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm	Kryetari/ZKA duhet të siguroj se kërkesat e raportimit të jashtëm janë përmbushur plotësisht për të arritur një funksionim konform kornizës së raportimit të jashtëm.		Pjesërisht, nuk është kryer vetëvlerësimi dhe vlerësimin e rrezikut dhe raportet financiare (të performancës)	
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari/ZKA duhet të sigurojë që plani i veprimit të rishikohet dhe në mënyrë të qartë të përcaktohet një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me anëtarët e identifikuar të stafit llogaridhënës, me fokus		Pjesërisht të adresuara, 7 në tërësi, 3 pjesërisht dhe 8 nuk janë	

	fillestar në ato të një rëndësie më të madhe		adresuar fare.	
4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari/ZKA duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Po		
4.2 Të hyrat (përfshirë edhe të hyrat vetanake)	Ne rekomandojmë Kryetarin/ZKA që ti çaset një planifikimi racional për të hyra, duke miratuar mekanizma të qartë të inkasimit. Fillimisht duhet siguruar një bazë e plotë për obliguesit tatimorë dhe obliguesve në baza tjera.			Nuk është adresuar.
4.2 Të hyrat (përfshirë edhe të hyrat vetanake)	Kryetari/ZKA duhet të siguroj se po bëhen harmonizime të rregullta në mes të departamenteve në periudha të rregullta për të gjitha llojet e të hyrave. Këto barazime duhet të bëhen edhe me gjendjen e Thesarit dhe të gjitha diferencat duhet të sqarohen.	Po		
4.3 Shpenzimet	Kryetari/ZKA - gjithashtu duhet të vlerësoj kapacitetet profesionale të zyrtarëve të prokurimit, si dhe të bëj të mundur ndjekjen e trajnimeve shtesë në fushën e prokurimit.	Po		
	Kryetari/ZKA duhet të siguroj mbikëqyrje adekuate gjatë zbatimit të procesit të prokurimit, nga faza e inicimit të procesit deri te finalizimi i projektit. Dobësitë e vërejtura tregojnë se duhet të ndërmerren masa të duhura për përmirësimin e kontrollit në mbikëqyrjen e projekteve në kuadër të ZAMV-së.			Nuk është adresuar.
	Kryetari/ZKA të sigurohet se zyrtarët e prokurimit veprojnë konform ligjit në fuqi për prokurim publik edhe me rastin e hapjes së tenderëve, siç parashihet edhe me	Po		

	nenin 58 të LPP.			
	Kryetari/ZKA duhet të siguroj planifikim më të mirë në mënyrë që produktet e ngjashme të grupohen me qëllim të tenderimit të përbashkët me qëllim të blerjes të produkteve me çmime sa më të mira.			Nuk është adresuar.
4.3.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet	Kryetari/ZKA duhet të sigurojë se pozitat që i përkasin tre punëtorëve të identifikuar, të cilat janë jashtë kriterëve të vendosura, duhet të adresohen si çështje urgjente.	Po		
	Kryetari/ZKA të vazhdoj bashkëpunimi me MAP-in për harmonizimin e informacionit sa i përket titujve të pozitave të punës, në mënyrë që të punësuarit të paguhen në mënyrë adekuate për pozitat e tyre të punës.			Nuk është adresuar.
4.3.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari/ZKA duhet të siguroj hartimin e Rregullores e cila në mënyrë të qartë përcakton kriteret, procedurat dhe raportimin e shpenzimeve të subvencioneve.			Nuk është adresuar.
	Kryetari/ZKA duhet të siguroj që në të gjitha rastet kur kërkohet që Organizata buxhetore të kryej prokurimin dhe kur është e mundur, të zbatohen rregullat e prokurimit. Gjithashtu, gjatë ndarjes së subvencioneve të zbatohen kriteret për përzgjedhjen e përfituesve të subvencioneve.			
	Kryetari/ZKA duhet të siguroj që shfrytëzuesit të dorëzojnë raporte mbi shpenzimin e mjeteve të ndara, si dhe çdo shfrytëzues të jetë komplet sa i përket dokumentacionit. Po ashtu, duhet ti shqyrtojë rastet e identifikuar për të përcaktuar se pse kriteret nuk janë aplikuar dhe të zhvillojë kontrolle të zgjeruara për të shmangur përsëritjen e rasteve të tilla	Rekomandimi është adresuar		
4.4.1 Pasuritë	Ne rekomandojmë Kryetarit/ZKA që të siguroj që e tërë			Nuk është adresuar.

kapitale dhe jo-kapitale	pasuria me të cilën disponon ZAMV të regjistrohet në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu, në fund të çdo viti duhet të themelohet komisioni për inventarizimin e pasurisë dhe gjendja e inventarizimit të harmonizohet me regjistrin e pasurisë.			
4.5 Auditimi i Brendshëm	Kryetari/ZKA duhet të sigurojë themelimin e një Komiteti të Auditimit dhe se aktiviteti i ardhshëm i NJAB të orientohet drejt zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në rrezik. Kjo do të ofronte menaxhmentit sigurinë e arsyeshme se kontrollet janë të dizajnuara mirë dhe operojnë si duhet.			Nuk është adresuar.